

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË CIKLIT FILLOR

1.METODA:LOJË ME GRUPE.

Në orën mësimore të lëndës matematikë klasa e I-A me temë mësimore: “Ditët e javës” metoda “Lojë në grupe”, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.

Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- U zhvillua me nxënësit loja e ditëve të javës.Nxënësit u ngritën para klasës në grupe me nga shtatë dhe i vendos në formën e rrethorit.
- Ata do të emërtojnë ditët e javës sipas radhës nga e para deri tek e shtata.Gjatë kohës që njëri grup zhvillon lojën nxënësit e tjerë vëzhgojnë dhe korrigjojnë saktësinë e lojës.Këtë lojë e praktikojmë me të tre grupet që krijohen në klasë dhe grupi që nuk i emërton sipas rrallës ditët e javës humbet.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e lojës, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë dhe fëmijët e përvetësojnë më mirë informacionin e ri.

Mësuese:Adela Bonjaku

Email: adela.bonjaku@gea.edu.al

2.METODA “PUNË NË DYSHE”.

Në orën mësimore të lëndës Matematikë, klasa 1-B, me temë mësimore “Zbritja veprimi i kundërt i mbledhjes” dhe konceptit kryesor rreth veprimeve me numrat, në njërën fazë realizuam punën në dyshe.

Puna në dyshe që kisha parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Puna në dyshe u zbatua në këtë mënyrë.

- Nxënësit ishin njohur me zbritjen si veprim i kundërt i mbledhjes, ndaj dhashë detyra për secilin nga nxënësit,, duke i ndarë në krahun e majtë e të djathtë.
- Përpara tyre kisha vendosur më parë fisha të bardha, në të cilën krahu i djathtë do të shkruante një veprim me mbledhje, kurse krahu i majtë veprimin e kundërt të mbledhjes që kishte shkruar shoku, pra me zbritje.
- Secili prej tyre punoi për detyrën e përcaktuar. Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, ndërkohë kam monitoruar klasën dhe kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilën dyshe në veprimtarinë përkatëse.
- Nxënësit lexuan veprimin e shkruar dhe më pas i vizatuan në fletore. Vura re që veprimet me numra që kishin shkruar nxënësit e përmbushën arritjen e rezultatit e të nxënit që kisha vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.
- Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në dyshe, sepse ajo krijon një ndërveprim me njëri-tjetrin dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuese: Dorjana Aliaj

dorjana.aliaj@gea.edu.al

3.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe (Abetare) klasa e I-C me temë mësimore: “Përsëritje e grupit të tretë të shkronjave” dhe me koncept kryesor krijimin e fjalive me fjalët e dhëna, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.

Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në 5 grupe me nga 5 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij, si dhe secili grup merr në tavolinën time etiketat me fjalët e ngatërruara, i jep shokëve nga një etiketë e më pas i vendosin ato në një karton, duke formuar me to nje fjali.
- Një nga anëtarët e grupit lexon fjalinë, grupet e tjera vlerësojnë nëse fjalët e vendosura në atë mënyrë krijojnë apo jo fjali.
- Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësuese kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.

Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 5 minuta, u vu re që ishin mbresëlënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

- Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo nxit bashkëpunimin dhe komunikimin mes nxënësve.Kjo metodë zhvillon aftësitë e të menduarit kritik dhe kreativ si dhe i bën nxënësit të ndjejnë rolin e tyre në një qëllim të përbashkët.

Mësuesi: Egesa Duka

egesa.duka@gea.edu.al

4. METODA "PUNË NË GRUPE".

Në orën mësimore të lëndës Abetare, klasa 1-D, me temë mësimore “Përsëritje e grupit të tretë të shkronjave (P,B,T,D,S,H)” dhe me koncept kryesor gjetjen e fjalëve dhe ndarjen në rrokje, metoda “Punë në grupe”, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.

Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në 6 grupe, ku secili grup kishte para një shkronjë të grupit të tretë.Secili grup pasi jap komandën shkruajtën nga dy fjalë që kanë në trup shkronjën e caktuar më parë.
- Nxënësit bashkëpunuan me njëri-tjetrin.Pasi përfunduan nga secili grup nxjerr para klase nga dy anëtarë.
- Secili anëtar thotë fjalën e gjetur dhe më pas e ndan në rrokje.
- Pas prezantimit të punës së bërë nga secili grup vura re se rezultatet e të nxënit ishin arritur me sukses dhe bashkëpunimi me njëri-tjetrin ishte i lartë.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo nxit bashkëpunimin dhe komunikimin mes nxënësve.Kjo metodë zhvillon aftësitë e të

menduarti kritik dhe kreativ si dhe i bën nxënësit të ndjejnë rolin e tyre në një qëllim të përbashkët.

Mësuesja: Entela Hidaj

entela.hidaj@gea.edu.al

5. METODA “LOJË”

Në orën mësimore të lëndës së Matematikës, klasa 2-A me temë mësimore “Çiftet e numrave që formojnë 10 dhe rrumbullakimi”, metoda e lojës, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit ose pjesa më e madhe e nxënësve të përfshihen në të nxënë. Metoda/ teknika u zbatua në këtë mënyrë:

- Para zhvillimit të lojës, rikujtuam dhe njëherë rregullat e rrumbullakimit të numrave në dhjetëshen më të afërt.
- Në smardbord prezantova lojën dhe ju tregoj nxënësve rregullat e lojës.
- Ndahet klasa në tre grupe. Secili grup do të luajë duke gjetur raketën me dhjetëshen më të afërt.
- Fiton lojën grupi që paraqitet më mirë. Përgëzohen nxënësit për pjesëmarrje aktive në lojë. Loja zgjati gati 10 minuta.
- Në fund u vu re që produktet e tre grupeve ishin mbresëlënëse, duke përmbytur arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të orës mësimore (Rrumbullakimi).

Përgëzohen dhe duartrokiten nxënësit për aktivizimin dhe saktësinë e treguar në punën në grup, për realizimin e lojës.

- Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh këtë metodë sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Flora Osmanaj

f.osmanaj@gea.edu.al

6. METODA: DRAMATIZIMI (INTERPRETIMI ME ROLE)

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, në klasën e 2-B, u zhvillua tema mësimore "Gjashtë vëllezërit peshkatarë", me fokus kryesor leximin shprehës dhe interpretimin me role. Për të realizuar këtë synim, u zbatua metoda “Interpretimi me role”, e cila rezultoi mjaft efektive në përfshirjen e të gjithë nxënësve në procesin e të nxënit.

Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Klasa u organizua në tre grupe, secili grup me nga tetë nxënës, të cilët u angazhuan në interpretimin shprehës të personazheve: Autori, vëllai 1, vëllai 2, vëllai 3, vëllai 4, vëllai 5, vëllai 6 dhe vajza.
- Nxënësit zbatuan rregullat e interpretimit duke përdorur intonacionin e duhur dhe duke shoqëruar leximin me gjeste domethënëse, të cilat ndihmuan në shprehjen më të plotë të emocioneve.
- Gjatë kohës që një grup interpretonte pjesën e tij, pjesa tjetër e klasës kishte rolin e spektatorëve aktivë, duke ndjekur me vëmendje dhe duke ofruar reagime konstruktive. Ky

angazhim i ndihmoi nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të dëgjuarit aktiv dhe vlerësimit kritik të performancave të njëri-tjetrit.

- Ata punuan në mënyrë të pavarur, duke u angazhuar aktivisht dhe duke bashkëpunuar në ndjekjen e saktë të njëri-tjetrit. Puna në grup u karakterizua nga bashkëpunimi i frytshëm dhe përqendrimi i plotë, duke i lejuar nxënësit të përvetësonin njohuritë përmes analizës dhe sintezës së tekstit.

Rezultatet e arritura

Përdorimi i kësaj metode ishte një mënyrë e efektshme ndërveprimi, sepse Nxënësit demonstruan një pjesëmarrje aktive dhe të plotë si aktorë dhe spektatorë. U rrit bashkëpunimi mes tyre përmes ndarjes së roleve dhe detyrave specifike. Nëpërmjet intonacionit dhe gjesteve, u thellua kuptimi i tekstit. U krijua një mjedis i këndshëm dhe krijues, ku fëmijët mësuan duke luajtur dhe duke vlerësuar njëri-tjetrin.

Ua sugjeroj kolegëve pasi kjo metodë është shumë e efektshme në nxitjen e të nxënësve aktiv dhe të përfshirjes maksimale të nxënësve. Ajo ndihmon në përvetësimin e informacionit në mënyrë më të qëndrueshme dhe argëtuese. Prandaj, sugjeroj që kolegët të përdorin sa më shpesh dramatizimin në orët mësimore, pasi ai i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike, kreative dhe sociale, si dhe të forcojnë aftësitë e të dëgjuarit dhe të reflektuarit mbi punën e tyre.

Mësuese: Irsida Seitaj

i.seitaj@gea.edu.al

7. TEKNIKA “TEATRI I LEXUESVE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuha Shqipe 2, klasa 2-C me temë mësimore “Gjashtë vëllezërit peshkatarë”, teknika “Teatri i lexuesve” e cila është parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Teknika u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën në 3 grupe me nga 8 veta dhe për secilin grup u ndanë rolet.
- Pjesa në tekst ishte e ndarë në dy skena. Dy grupe improvizuan skenën një, ndërsa grupi i tretë skenën dy.
- Paraprakisht kisha kërkuar nga nxënësit të përgatishin disa grepa me magnet dhe disa peshq me kapëse fletash që magneti t`i tërhiqte që shfaqja të bëhej më interesante.
- Secili grup përmbushi arritjen e rezultatit të të nxënësve që ishte vendosur për orën mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh teknikën “Teatri i lexuesve”, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë. Rolet ndahen sipas shkallës së vështirësisë, kështu që të gjithë nxënësit të jenë pjesëmarrës. Kjo teknikë ndihmon edhe nxënësit që kanë aftësi në të interpretuar por vështirësi të mësojnë përmendësh të shpalosin aftësitë e tyre.

Mësuesja: Dorina Haxhiu

dorinahaxhiu@gea.edu.al

8.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Dituri Natyre klasa 2-D me temë mësimore “Nxehja dhe ftohja”, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.

Metoda e përzgjedhur u zbatua në këtë mënyrë.

- Ndava klasën në 4 grupe me nga 6 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij.
- Secili grup kishte të mirëorganizuar mjetet që nevojiteshin për eksperimentet që do të zhvillonim.
- Secili prej grupeve punuan të pavarur, duke u vëzhguar dhe ndihmuar secilin grup aty ku ishte e nevojshme ndihma ime.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 2 minuta, u vu re që produktet e tyre ishin mbresëlënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.
- Nxënësit kuptuan në mënyrë të drejtëpërdrejtë sesi temperatura (e nxehtë dhe e ftohtë), ndikon në ndryshimin e formave të trupave të ndryshëm (çokollata, gjalpi, akulli...).

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe, sepse krijon një ndërveprim, përfshirje të lartë në të nxënë si dhe ka efikasitet të lartë (grupi mund të përfundojë më shpejt një projekt se sa një individ, pasi puna ndahet dhe mund të realizohet në të njëjtën kohë nga njerëz të ndryshëm).

Mësuesja: Anxhela Bushaj

anxhela.bushaj@gea.edu.al

9. METODA “DIAGRAMI I VENIT”

Në orën mësimore të lëndës së Matematikës në klasën e III-A u zhvillua tema “Eksplorojmë trupat gjeometrikë”. Koncepti kryesor ishte dallimi i veçorive të trupave gjeometrikë (krahasuar edhe me figurat gjeometrike, por edhe krahasimi midis vetë trupave gjeometrike).

- Për arritjen e të nxënit të nxënësve u përdor metoda “Diagrami i Venit”.
- Aktiviteti u mbështet në informacionin e mbledhur nga puna individuale dhe puna në dyshe e nxënësve.
- Ky bashkëveprim i lejoi nxënësit të dallojnë figurat nga trupat gjeometrikë dhe të sjellin të veçantat e trupave gjeometrikë që kanë mësuar deri tani.
- Shkëmbimi i ideve dhe i njohurive u realizua përmes bashkëpunimit me shokun e bankës për ndërtimin e diagramit të Venit.
- Çdo rresht punoi me një çift trupash të përcaktuar që në fillim të aktivitetit. Rreshti i parë punoi për ndërtimin e diagramit për kubin dhe kuboidin, rreshti i dytë punoi për ndërtimin e diagramit për piramidën dhe konin dhe rreshti i tretë punoi për ndërtimin e diagramit për sferën dhe cilindrin.

- Çdo rresht u përfaqësua në tabelë nga një dyshe nxënësish për të demonstruar arritjet e veprimtarisë.
- Nxënësit shprehën njohuritë individuale, shfaqën aftësinë e të punuarit në grup, aftësinë e përdorimit të fjalorit lëndor për përshkrimin e trupave gjeometrikë duke bashkëpunuar në mënyrë aktive, aftësinë për të analizuar informacionin në mënyrë logjike, aftësinë për të vlerësuar të përbashkëtat dhe ndryshimet midis trupave gjeometrikë.

Metoda e përdorur ndihmoi në realizimin e rezultatit të të nxënësve dhe në përvetësimin e konceptit bazë të orës mësimore. Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e diagramit të Venit, sepse ajo krijon ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënësve. Një arsye tjetër për përdorimin e kësaj metode është ndihma që u jep nxënësve të kuptojnë dhe të përvetësojnë më lehtë koncepte komplekse, përmes një mënyre praktike dhe argëtuese për ta.

Mësuesja: Klodjana Hoxha

k.hoxha@gea.edu.al

10.METODA “LEXIM ME ROLE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa 3 – B u realizua tema mësimore “Gjithshka ndryshon” me koncept kryesor të lexuarit në mënyrë shprehëse. Kjo temë u realizua me anën e metodës “Interpretim me role”. Kjo metodë më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënësve. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në tërësi duke ndarë rolet dhe duke i udhëzuar për të vepruar në zinxhir, njëri pas tjetrit.
- Nxënësit zbatuan rregullat e interpretimit shprehës duke përdorur intonacionin e duhur për një shprehje të qartë të mesazhit. Interpretimi u sugjerua të plotësohet me gjeste.
- Nxënësit punuan të pavarur, duke u angazhuar në ndjekjen e saktë të njëri-tjetrit.

Rezultatet e punës së tyre në grup ishin domethënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënësve që ishte vendosur për këtë koncept të orës mësimore. U mundësua bashkëveprimi, përqendrimi, pjesëmarrja e plotë e nxënësve.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e interpretimit me role, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënësve. Gjithashtu u jep mundësi të gjithë fëmijëve të memorizojnë informacionin duke u bazuar te analiza dhe sinteza e tekstit.

Mësuesja: Lindita Mitrovica

lindita.mitrovica@gea.edu.al

11. METODA “LËVIZ-NDALO-KRIJO NË DYSHE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuha shqipe, klasa 3 C me temë mësimore “Gjinia e emrit” dhe me koncept kryesor gjetjen e gjinisë femërore dhe mashkullore të emrave. Metoda e përdorur në orën mësimore më mundësoi përfshirjen e të gjithë nxënësve. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Nxënësit lëvizën lirshëm nëpër klasë deri në një komandë ndalimi.
- Krijuan dyshe dhe hynë në komunikim me njëri-tjetrin në formën e një loje.
- Njëri nxënës tha një emër dhe tjetri gjen në cilën gjini duke dhënë trajtën përfaqësuese të emrit, trajta e shquar , numri njëjës përmes pyetjeve Cili ? - Cila?

- Më pas me ndihmën time, fëmijët bënë një përmbledhje të njohurive gjuhësore në lidhje me emrin dhe gjininë e tij..

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën “Lëviz-Ndalo-Krijo në dyshe”, sepse në këtë mënyrë njohuritë përftohen përmes komunikimit dhe lojës, që është aq e nevojshme për këtë moshë nxënësish.

Mësuesja: Sidiola Laze

sidiola.laze@gea.edu.al

12.METODA “LOJË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës matematikë , klasa IV- A , me temën” **Ushtrime për përforcimin e njohurive të shumëzimit**” dhe me koncept kryesor kryejmë veprime me shumëzimin,metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në fazën e tretë të orës mësimore në këtë mënyrë:

- Nxënësit i ndava në 6 grupe me nga katër veta, ku secili grup do të kryejë lojëra me veprimin e shumëzimit.
- Grupi i I dhe i II do të zhvillojë lojën me “Zare”, ku nxënësit do të hedhin zaret dhe numrat që bien do i shumëzojnë dhe do të gjejnë përfundimin.
- Grupi i III dhe i IV do të zhvillojë lojën me pazëll, duke përdorur veprimin e shumëzimit do të krijojnë figurën e dhënë.
- Grupi i V dhe i VI do të zhvillojë lojën “Mos u nxeh”, po me të njëjtin qëllim. Secilit grup i tregohen rregullat e lojës dhe të gjithë grupet kryejnë aktivitetin në të njëjtën kohë.
- Në fund të aktivitetit prezantohet puna për secilin grup dhe fituesit e lojës “Mos u nxeh”.

Ua sugjeroj kolegëve që ta përdorin sa më shpesh këtë metodë” Lojë në grup”sepse këto lojëra e bëjnë mësimin më tërheqës .Kur fëmijët argëtohen , ata përqëndrohen më shumë dhe e përvetësojnë më lehtë konceptin e shumëzimit.

-Rrit bashkëpunimin dhe punën në grup dhe zhvillojnë aftësi sociale të rëndësishme.

-Nxënësit aktivizohen dhe mësojnë përmes praktikës .

-Lojërat krijojnë një atmosferë positive në klasë dhe nxënësit ndihen më të motivuar dhe e shohin

shumëzimin si një sfidë të këndshme dhe jo si një detyrë të lodhshme.

-Përmirëson të menduarit logjik dhe strategjik.

Mësuesja: Eva Raka

e.raka@gea.edu.al

13.METODA: DRAMATIZIMI (INTERPRETIMI ME ROLE)

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, në klasën 4-C, u zhvillua tema mësimore "E mrekullueshmja... Picë", me fokus kryesor leximin shprehës dhe interpretimin me role. Për të realizuar këtë synim, u zbatua metoda Interpretimi me role, e cila rezultoi mjaft efektive në përfshirjen e të gjithë nxënësve në procesin e të nxënësve.

Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Klasa u organizua në katër grupe, secila me nga pesë nxënës, të cilët u angazhuan në interpretimin shprehës të personazheve: Autori, Mbreti, Mbretëresha, Konti, Toto.
- Nxënësit zbatuan rregullat e interpretimit, duke përdorur intonacionin e duhur dhe duke shoqëruar leximin me gjeste domethënëse, të cilat ndihmuan në shprehjen më të plotë të emocioneve.
- Gjatë kohës që një grup interpretonte pjesën e tij, pjesa tjetër e klasës kishte rolin e spektatorëve aktivë, duke ndjekur me vëmendje dhe duke ofruar reagime konstruktive. Ky angazhim i ndihmoi nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të dëgjuarit aktiv dhe vlerësimit kritik të performancave të njëri-tjetrit.
- Ata punuan në mënyrë të pavarur, duke u angazhuar aktivisht dhe duke bashkëpunuar në ndjekjen e saktë të njëri-tjetrit. Puna në grup u karakterizua nga bashkëpunimi i frytshëm dhe përqendrimi i plotë, duke i lejuar nxënësit të përvetësonin njohuritë përmes analizës dhe sintezës së tekstit.

Përdorimi i kësaj metode u tregua shumë efektiv, pasi:

- Nxënësit demonstuan një pjesëmarrje aktive dhe të plotë si aktorë dhe spektatorë.
- U rrit bashkëpunimi mes tyre përmes ndarjes së roleve dhe detyrave specifike.
- Përmes intonacionit dhe gjesteve, u thellua kuptimi i tekstit.
- U krijua një ambient i këndshëm dhe kreativ, ku fëmijët mësuuan duke luajtur dhe duke vlerësuar njëri-tjetrin.

Rekomandim për kolegët

- Kjo metodë është shumë efektive në nxitjen e të nxënësve aktiv dhe të përfshirjes maksimale të nxënësve.
- Ajo ndihmon në përvetësimin e informacionit në mënyrë më të qëndrueshme dhe argëtuese. Prandaj, sugjeroj që kolegët të përdorin sa më shpesh dramatizimin në orët mësimore, pasi ai i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike, krijuese dhe sociale, si dhe të forcojnë aftësitë e të dëgjuarit dhe të reflektuarit mbi punën e tyre.

Mësuesja: Dëshira Lashi

deshira.lashi@gea.edu.al

14. TEKNIKA “PUNË NË DYSHE”

Në orën mësimore të lëndës: **Gjuhë shqipe, klasa IV-B**, me temë mësimore “**Gjinia dhe numri i mbiemrit**” me koncept kryesor “Analizë të mbiemrit në gjini dhe numër”parashikova në planin e orës mësimore teknikën e punës në grupe dyshe. Kjo teknikë më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë gjatë orës së mësim. Teknika u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në grupe me nga 2 veta ku për secilin grup u ndanë detyrat.Nisa unë së bashku me një nga nxënësit ilustrimin e teknikës. Në dyshe nxënësit realizuan përmbushjen e konceptit kryesor të mësimit duke treguar njëri një emër dhe më pas duke i pasuar topin shokut tjetër për të thënë një mbiemër .
- Nxënësi tregon numrin dhe gjininë e mbiemrit që ka thënë.
- Metoda punohet me të gjithë nxënësit që janë prezent në klasë duke bërë një gjithëpërfshirje të tyre në mësim.

Veprimtaria siguroi përmbushjen dhe arritjen e rezultatit të të nxënët që ishte vendosur lidhur me atë koncept .Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh veprimtarinë e punës në grupe dyshe, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë, një përqendrim më të madh për të përvijuar mendimin e paraardhësit.

Mësuesja: Etleva Merko

etleva.merko@gea.edu.al

15. METODA “PUNË ME GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës **Matematikë**, klasa **5-A** me temë mësimore: **Sistemi 24-orësh** dhe me koncept kryesor: Të kuptuarit e sistemeve standarde të matjes së kohës duke i përdorur ato për të kryer llogaritje nëpër ushtrime të ndryshme, për të zhvilluar aftësitë logjike matematikore në problema me këto njësi, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në 6 grupe me nga 4 nxënës dhe dhashë detyrën për secilin grup, ku përcaktova qartë qëllimet.
- Nxënësit ndanë rolet në grup për secilin anëtar në mënyrë të tillë që puna të jepte rezultat dhe kënaqësi.
- Secili grup u pajis me fletë të mëdha të bardha, shënjes me ngjyra/markers dhe ngjitës letre. Fletë me ushtrime të përgatitura nga mësuesja.
- Secili grup punoi për detyrën (*1- Shkrimin e orës me fjalë. 2- Leximin e orëve të dhëna. 3- Shkrimin e orës digjitale. 4- Zgjidhjen e problemës me llogaritjen e orës. 5- Zgjidhjen e ushtrimit me mbledhjen e orëve. 6- Zgjidhjen e situatës konkrete praktike me zbritjen e orës.*
- Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësuese kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Pasi diskutuan rreth pyetjeve dhe ushtrimeve të dhëna, përfaqësuesit e grupeve argumentuan zgjidhjen para klasës në tabelë duke iu përmbajtur dhe arritur rezultatet e të

nxënit të përcaktuara në këtë temë mësimore bashkë me konceptin kryesor matematikor të përcaktuar.

- Rezultatet e punës së tyre ishin mbresëlënëse.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës me grupe, sepse krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë. Gjatë punës me këtë metodë nxënësit janë në gjendje të shkëmbejnë pikëpamjet, të mendojnë e të shprehen lirshëm, të punojnë për një detyrë së bashku, në mënyrë të tillë që çdo anëtar grupi arrin të kontribuojë në procesin e të nxënit dhe më pas, mëson të gjitha konceptet e reja, nga faza e parashikimit në përfundim.

Mësuesja: Nevila Fero

nevila.fero@gea.edu.al